

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**



Programi mësimor

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

për vitin I

Arsimi i gjimnazit

Shkup, 2025

TË DHËNA THEMELORE PËR PROGRAMIN MËSIMOR

Lënda mësimore	<i>Gjuhë shqipe dhe letërsi</i>
Lloji/kategoria e lëndës mësimore	E detyrueshme
Viti	I (i parë)
Temat/fushat e programit mësimor	• <i>Gjuhë dhe komunikim</i> • <i>Letërsi, të shprehurit dhe krijimtari</i> • <i>Njohuri mediatike</i>
Numri i orëve mësimore	4 orë në javë / 144 orë në vit
Pajisjet dhe mjetet	• Pajisjet teknike në klasë: tabelë elektronike, tabelë shkollore, teknologji kompjuterike, printer. • Mjetet dhe burimet mësimore: fotografi, afishe nga veprimtarë dhe nga vepra letrare, diagrame dhe ilustrime për material mësimor, tabela që përcjellin materialin sipas fushave programore, fjalorë, fjalorë drejtshkrimor, leksikonë, enciklopedi, libra, programe kompjuterike edukative, regjistrime transmetimesh, regjistrime audio-vizuale; • Biblioteka e klasës, biblioteka e shkollës.
Normativi për kuadrin mësimor	Mësimdhënjen e lëndë së gjuhës shqipe dhe letërsisë në vitin I të arsimit të gjimnazit mund ta realizojë personi që ka kryer drejtimin arsimor të programit studimor: • Gjuhë dhe letërsi shqipe - VII/1 ose VI A, 240 kredi

REZULTATET E TË NXËNIT

Fusha programore: GJUHË DHE KOMUNIKIM Gjithsej: 55 orë	
Rezultatet e të nxënit: <i>Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:</i> - të shpjegojë rolin e gjuhës si mjet ndërveprimi efektiv; - të interpretojë aspektet historike dhe gjuhësore të zhvillimit të gjuhës shqipe dhe rendit karakteristikat e saj; - të zbatojë theksin e saktë të fjalëve dhe fjalive gjatë të folurit; - të zbatojë rregullat drejtshkrimore (përdorimin e shkronjave të mëdha, të shkruarit e fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë në mes, ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit, të shkruarit e datave, shkurtesat, akronimet dhe shenjat e pikësimit); - të dëgjojë dhe të lexojë për të kuptuar; - të krijojë tekste për komunikim zyrtar dhe jozyrtar në kontekste të ndryshme. <i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i> - komunikimi efektiv varet nga përshtatja e përdorimit të gjuhës në kontekste, forma dhe mjedise të ndryshme; - të folurit e gjuhës standarde shqipe dhe të shkruarit duke ndjekur rregullat drejtshkrimore kontribuon në përmbushjen personale dhe profesionale.	
Përmbajtjet (dhe nocionet/konceptet):	Standardet e vlerësimit:
RRETH GJUHËS SHQIPE	
Shkenca e gjuhës (gjuhë, sistemi i shenjave, fjalim, komunikim – dërgues i mesazhit, mesazh, marrës i mesazhit; kod, llojet e komunikimit, njëkahësh/i ndërsjellë, verbal/joverbal, shenjë, simbol, sinjal; metagjuhë, funksionet e gjuhës)	- Shpjegon rëndësinë e gjuhës si mjet për komunikim dhe fuqinë e saj mbi mënyrat e tjera të komunikimit. - Krahason dhe interpreton veçoritë dhe funksionet e gjuhës. - Jep shembuj të llojeve të ndryshme të komunikimit. - Demonstron angazhimin në bisedë/ fillimin e komunikimit me shkrim në gjuhën standarde shqipe. - Shpjegon kuptimin e termit metagjuhë.
Gjuha shqipe në familjen e gjuhëve indoevropiane	Shpjegon prejardhjen e gjuhës shqipe si degë e veçantë në familjen e gjuhëve indoevropiane.

(klasifikimi, gjuhët indoevropiane, veçoritë e gjuhës standarde shqipe)	• Identifikon dhe shpjegon veçoritë e gjuhës standarde shqipe dhe afërsitë dhe dallimet e saj me gjuhët e tjera indoevropiane.
Zhvillimit historik i gjuhës letrare shqipe (Periudha parahistorike; Periudha historike – nga shek. I deri te shkrimet e para; Periudha e re- nga shkrimet e para deri në ditët e sotme)	• Dallon periudhën parahistorike. • Krahason veçoritë e përgjithshme të dëshmive të periudhës parahistorike dhe të shkrimeve të para të periudhës historike të gjuhës shqipe. • Njeh etapat e zhvillimit të gjuhës letrare shqipe në periudhën e re.
GJUHËSI	
Degët kryesore të gjuhësisë (fonetikë, leksikologji, gramatikë - morfologji dhe sintaksë)	• Shpjegon rolin e gjuhësisë si shkencë që merret me studimin e gjithanshëm të gjuhës. • Dallon degët kryesore të gjuhësisë dhe shpjegon rolin e tyre.
Fonetikë dhe fonologji (rrafshi gjuhësor, fonetikë, fonologji, tingull, fonemë, shkronjë, ortografi, ortoepi; mënyra e artikullimit të tingujve; sistemi fonetik: zanore, grupe (togje) zanoresh, diftong; bashkëtingëllore, grupe (togje) bashkëtingëlloresh; ndryshime fonetike)	• Shpjegon funksionin dhe rëndësinë e fonetikës dhe fonologjisë si degë të gjuhësisë. • Shpjegon origjinën dhe kuptimin e fjalëve: fonemë, grafemë, fonetikë, fonologji, ortografi (drejtshkrimi), ortoepi (drejtshqiptimi). • Shtjellon dallimin midis tingullit dhe fonemës. • Njeh dhe dallon organet e të folurit dhe funksionin e tyre gjatë nyjëtimit të tingujve. • Klasifikon zanoret sipas vendit të ngritjes së gjuhës (<i>të përparme, të mesme, të prapme</i>), sipas shkallës të ngritjes së gjuhës (<i>të hapura, gjysmë të hapura, të mbyllura</i>) dhe sipas pjesëmarrjes ose mospjesëmarrjes së buzëve (<i>të buzorëzuara, të pabuzorëzuara</i>). • Dallon shqiptimin e grupit (togut) zanor nga diftongu dhe i shkruan drejt ato. • Klasifikon bashkëtingëlloret sipas mënyrës së formimit (<i>mbylltore, shtegore, hundore, anësore dridhëse</i>), sipas vendit të formimit (<i>buzore, dhëmbore, alveolare, paraqiełłzore, qiełłzore</i>) dhe sipas pjesëmarrjes së zërit (<i>të zëshme, të pazëshme</i>). • Zbaton drejtshkrimin dhe drejtshqiptimin e bashkëtingëlloreve dhe grupeve (togjeve) të bashkëtingëlloreve. • Përcakton variantet e tingullit brenda një fjale a disa fjalësh të ndryshme. • Shpjegon shkaqet pse një tingull artikullohet në mënyra të ndryshme dhe jep shembuj përkatës.

	• Identifikon dhe shpjegon ndryshimet fonetike të tingujve (<i>asimilimin, disimilimin, metafoninë, apofoninë, metatezën, rotacizmin, elizioni, rënien dhe shtimin e tingujve</i>) dhe jep shembuj për to. • Respekton rregullat për zbatimin e ndryshimeve fonetike të tingujve gjatë komunikimit me gojë dhe me shkrim.
Theksi (theks i fjalës, theks i fjalisë; theks dinamik, theks melodik; theksi i lëvizshëm/i lirë, theks i palëvizshmëm/i qëndrueshëm; theks fundor, parafundor, tejfundor; rrokje të theksuara, rrokje të patheksuara; fjalë klitike)	• Shpjegon karakteristikat e theksit në gjuhën standarde shqipe. • Dallon dhe sqaron theksin e fjalës nga theksi i fjalisë. • Shqipton saktë fjalën duke theksuar më tepër rrokjen e theksuar kur lexon dhe kur flet. • Identifikon dhe shqipton saktë fjalinë duke theksuar më tepër fjalën e theksuar. • Shpjegon theksin dinamik, theksin e lëvizshëm dhe të pa lëvizshëm. • Identifikon theksin fundor, parafundor dhe tejfundor. • Shënon saktë me shenjë theksi (`) fjalët njërrrokëshe, dyrrrokëshe, trerrokëshe dhe shumërrrokëshe. • Identifikon dhe vë në dukje theksin në fjalët e përbëra dhe në fjalët e huazuara. • Dallon fjalët klitike dhe i ndan ato sipas pozicionit (proklitike, enklitike).
Drejtshkrim dhe drejtshqiptim	• Zbaton rregullat e drejtshkrimit dhe drejtshqiptimit sipas ndryshimeve fonetike të tingujve. • Shkruan dhe shqipton drejt fjalët me prejardhje të huaj. • Zbaton rregullat e shkrimit të fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë në mes. • Shpjegon dhe jep shembuj fjalësh që shkruhen njësh, ndaras dhe me vizë në mes. • Zbaton përdorimin e drejtë të shkronjave të mëdha. • Zbaton rregullat për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit. • Shpjegon dhe shkruan drejt datat.
Shenja të pikësimit (pikë (.), presje (,), pikëpresje (:), dy pika (:), shumëpikësh(...), pikëpyetje (?), pikëçuditje (!), vizë (–), vizë lidhëse (-), kllapa ((), []), pjerrët (/), apostrof ('), thonjëza ("), yll (*), shenjë theksi (`), hapësirë)	• Shpjegon funksionin dhe kuptimin e shenjave të drejtshkrimit. • Zbaton drejt shenjat e pikësimit në komunikim me shkrim. • Gjen dhe korrigjon gabimet në përdorimin e shenjave të pikësimit në tekst.

Fjalët e shkurtuara dhe shkurtesat (fjalët e shkurtuara – akronimet, shkurtesat; mënyrat se si formohen shkurtesat në gjuhën shqipe, lista e shkurtesave në gjuhën shqipe; lista e shkurtesave të zakonshme)	• Dallon fjalët e shkurtuara nga shkurtesat. • Jep shembuj fjalësh të shkurtuara dhe shkurtesa të zakonshme sipas rregullave të ndryshme. • Hulumton fjalë të shkurtuara dhe shkurtesa në botimin <i>“Drejtshkrimi i gjuhës shqipe”</i> • Zbaton drejt shkurtesat dhe fjalët e shkurtuara gjatë të shkruarit.
TË DËGJUARIT, TË LEXUARIT DHE TË SHKRUARIT	
Të dëgjuarit për të kuptuar Të lexuarit për të kuptuar Të shkruarit e teksteve për komunikim zyrtar dhe jozyrtar (formatet e shkresave të komunikimit zyrtar: letër, procesverbal, lutje, kërkesë; struktura e komunikimit zyrtar: titulli, data, marrësi, subjekti (lënda), përmbajtje e tekstit, nënshkrim, gjuhë formale; formatet e komunikimit jozyrtar: letër jozyrtare, mesazh elektronik (e-mail) ose mesazh në rrjetet sociale)	• Njeh dhe riprodhon informacion nga një tekst i dëgjuar. • Shpjegon dhe interpreton të kuptuarit e mesazheve dhe të koncepteve nga një tekst i dëgjuar. • Zbaton informacionin e dëgjuar në situata ose në kontekste të tjera. • Identifikon dhe riprodhon fakte dhe detaje kryesore nga teksti i lexuar. • Shpjegon dhe përmbledh idetë dhe temat kryesore nga një tekst i lexuar. • Zbaton informacionin ose konceptet nga teksti i lexuar në kontekste ose situata të tjera. • Gjen dhe interpreton informacionin e kërkuar në tekst, duke përfshirë edhe informacionin e dhënë me tabela, me grafikë, me harta, me të dhëna statistikore dhe me diagrame. • Identifikon dhe riprodhon elemente dhe formatet kryesore nga tekstet zyrtare dhe jozyrtare. • Bën dallim mes stilit dhe strukturës në komunikimin formal (zyrtar) dhe atë joformal (jozyrtar) gjatë komunikimit me shkrim. • Njeh dhe përdor gjuhën formale dhe format e përshtatshme në komunikimin zyrtar, duke respektuar strukturën gjatë shkrimit të tyre. • Njeh dhe zbaton gjuhën joformale duke përdorur shprehje bisedash, shkurtesa dhe emotikone (shenja), të përshtatshme për kontekstin dhe audiencën kur shkruan letra personale, e-maile joformale ose mesazhe në rrjetet sociale.
Shembuj veprimtarish: Veprimtari individuale • Nxënësit hulumtojnë llojet e komunikimit dhe paraqesin shembuj nga jeta e përditshme. Prezantimi përfshin të gjitha mënyrat e reja të komunikimit, kanalet e komunikimit, llojet e shenjave të përdorura në komunikim, duke theksuar rolin e gjuhës si një mjet i veçantë komunikimi.	

- Nxënësit shkruajnë një tekst sipas zgjedhjes së tyre dhe kontrollojnë saktësinë e asaj që kanë shkruar duke përdorur versionin elektronik të *Drejtshkrimin të gjuhës shqipe (Tiranë, 1973)*.

Veprimtari dhe ushtrime praktike

- Tekstet të ndryshme (letrare dhe joletrare) lexohen me zë në klasë, ku nxënësit e tjerë (me ndihmën e mësimeve) identifikojnë gabimet në theks dhe gabimet e tjera në përdorimin e gjuhës standarde shqipe, më pas i korrigjojnë ato dhe tregojnë se si duhet të jetë e saktë.
- Nxënësve u jepet detyrë të korrigjojnë tekste nga stile të ndryshme funksionale që përmbajnë një sërë gabimesh drejtshkrimore.
- Pas ndjekjes së një ngjarjeje sportive ose muzikore, nxënësit duhet të shkruajnë një tekst me informacion bazë për ngjarjen. Ata duhet të ofrojnë disa tituj për tekstin dhe më pas të zgjedhin atë më të përshtatshmin që do të siguronte lexueshmëri më të madhe në faqen e internetit të shkollës.
- Fillimisht nxënësit i shkruajnë një letër zyrtare bizneseve dhe kompanive nga komuniteti ku jetojnë duke u kërkuar atyre që t'i ndihmojnë nxënësit të realizojnë një ngjarje humanitare *"Dita e ushqimit"*. Më pas, ata hartojnë edhe një letër tjetër duke i falënderuar ata për mbështetjen që kanë marrë.

Veprimtari hulumtuese:

- Nxënësit hulumtojnë karakteristikat e gjuhës standarde shqipe në krahasim me disa gjuhë të tjera indoevropiane. Për secilën veçori, ata citojnë shembuj që kanë gjetur përmes hulumtimit për të ilustruar dallimet midis gjuhëve.

Kuize dhe gara

- Në orë mësimore zhvillohet një garë e quajtur *"Kush është dëgjuesi më i mirë?"*. Nxënësit dëgjojnë/shikojnë një emision për një temë të caktuar, për shembull një temë ekologjike: "Shkupi - qyteti më i ndotur në botë" dhe më pas i përgjigjen listës së pyetjeve që mësimeve/ja ka përgatitur në lidhje me përmbajtjen që po dëgjojnë/shikojnë. Gara përmban pikë dhe një kohë të caktuar për të përgjigje.
- Nxënësit marrin pjesë në një gatë të titulluar *"Kush është lexuesi më i mirë?"*, ku u përgjigjen pyetjeve dhe zgjidhin detyra që lidhen me një tekst që paraqet fakte dhe informacione për inteligjencën artificiale dhe zbatimin e saj në jetën e përditshme.

Fusha programore: **LETËRSI, TË SHPREHURIT DHE KRIJIMTARIA**

Gjithsej: 75 orë

Rezultatet e të nxënit:

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:

1. të dëgjojë dhe të lexojë për të kuptuar tekste nga periudha të ndryshme letrare;
2. të analizojë tekste letrare duke përdorur koncepte teorike-letrare nga narratologjia dhe nga poetika;
3. të shpjegojë dhe të dallojë gjinitë letrare, llojet dhe karakteristikat e tyre përmes shembujve nga letërsia shqipe dhe nga ajo botërore, përfshirë këtu edhe letërsinë popullore shqipe.
4. të formulojë pikëpamje të arsyetuara dhe kritike për veprat letrare dhe për dukuritë kulturore e shoqërore, duke i lidhur ato me kontekstet bashkëkohore.
5. të krijojë tekste origjinale – ese dhe tekste të tjera krijuese, duke respektuar normat gjuhësore, strukturën dhe rregullat e të shprehurit me shkrim.

Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:

1. të lexuarit për të kuptuar i veprave letrare ndikon në zhvillimin e aftësive komunikuese, në mënyrën e të menduarit dhe në zhvillimin e krijimtarisë.
2. aftësitë e fituara përmes leximit dhe interpretimit të teksteve letrare janë të dobishme për të mësuar, për të përvetësuar dhe për të zbatuar njohuri në të gjitha fushat e tjera të jetës.

Përmbajtjet (dhe nocionet/konceptet):	Standardet e vlerësimit:
TEORIA E LETËRSISË	
Arti dhe llojet e tij (arkitektura, piktura, skulptura, muzika, aktrimi, letërsia)	• Njih llojet e arteve dhe shpjegon se si ndryshon letërsia nga artet e tjera. • Përkufizon nocionin letërsi dhe rendit karakteristikat themelore të saj. • Njih llojet e kritikës letrare dhe shpjegon karakteristikat e tyre.
Shkenca e letërsisë (teoria e letërsisë, kritika letrare: kritika stilistike, estetike, impresioniste, biografike, filozofike, gazetareske; historia e letërsisë)	

Ndarja e letërsisë (gjinitë letrare: lirika, epika, dramatika; llojet lirike: elegjia, himni, oda, poezia, vjersha, ditirambi, epigrami, epitafi, idila; llojet epike: epi, romani, novela, tregimi, skica, përralla, legjenda; llojet epiko-lirike: balada, poema, fabula, romani në vargje; llojet dramatike: tragjedia, komedia, drama; miti, mitologjia, folklori)	• Shpjegon gjinitë dhe llojet letrare dhe përshkruan karakteristikat e tyre. • Njeh dhe dallon gjinitë dhe llojet e ndryshme letrare në tekstet e dhëna. • Identifikon gjinitë dhe llojet e ndryshme letrare, duke përmendur shembuj për secilën prej tyre. • Përshkruan karakteristikat e mitit dhe të letërsisë popullore. • Shpjegon se si mitet dhe përrallat shërbejnë si burime për letërsinë artistike.
Lirika (gjuha poetike - emocionaliteti, përfytyrimi, muzikaliteti, ritmi, kuptim konkret dhe figurativ i fjalëve, vjershërimi - vargu, metrika e vargjeve, llojet e vargjeve, strofa; kompozicioni - strofik, heterostrofik; rima; llojet lirike sipas motivit: lirika e dashurisë, e peisazhit, atdhetare (patriotike), filozofike, sociale, humoristike, moderne; subjekti lirik) Figurat stilistike (metafora, metonimia, sinekdoka, personifikimi, eufemizmi, ironia, epiteti, alegoria, simboli, krahasimi, antiteza, hiperbola, gradacioni, paradoksi, elipsa, asindetoni, polisindetoni, asonanca, aliteracioni, onomatopeja, anafora, epifora, paranomaza)	• Shpjegon nocionet: poezi lirike, gjuhë poetike, vjershërim, figura stilistike shprehëse. • Identifikon dhe interpreton elementet e gjuhës poetike (emocionalitetin, përfytyrimin, muzikalitetin, ritmin, kuptimin konkret dhe figurativ të fjalëve). • Njeh dhe dallon karakteristikat stilistike të veprës lirike sipas motivit dhe përmbajtjes. • Njeh dhe interpreton figurat stilistike dhe funksionin e tyre në vargje. • Dallon figura stilistike në raport me stilin, gjuhën dhe kohën në të cilën është krijuar vepra. • Krijon vepra me strukturë poetike duke zbatuar njohuritë për poezinë lirike. <i>Vepra/poezi me zgjedhje për analizë:</i> - <i>“Bota sillet rreth jugut”</i> nga Agim Vinca - <i>“Për ty”</i> nga Esad Mekuli - <i>“Vetë përballë Erosit”</i> nga Lindita Ahmeti - <i>“Ora e liqenit”</i> nga Resul Shabani - <i>“Alga e dalë nga deti”</i> nga Nehas Sopaj - <i>“Lirika maqedonase e dashurisë”</i> (edituar nga Vesna Mojsova-Çepishevska dhe Ivan Antonovski) - <i>“Poezi të zgjedhura”</i> nga Vasko Popa

	- <i>"Përzgjedhje nga Masnavi"</i> nga Mevlana
Epika (motivi, tema, ideja, fabula, komploti, kompozicioni, rrëfimi (narracioni), rrëfimtari (narratori), format e rrëfimit; retrospeksion, introspeksion, prospeksion; karakteri, personazhi, heroi, ngjarja, koha, hapësira) Llojet epike në vargje (poema heroike, epopeja, epi) Llojet epike në prozë (tregimi, skica, novela, romani; legjenda, përralla) Llojet epiko-lirike (balada, poema, fabula, romani në vargje)	• Numëron dhe përshkruan karakteristikat themelore të epikës. • Njih dhe dallon tiparet e epikës nëpërmjet elementeve në raport me gjinitë e tjera. • Paraqet llojet e veprave epike sipas ligjëritit dhe përshkruan tiparet e tyre. • Paraqet llojet e veprave epike sipas vëllimit/madhësisë dhe kompleksitetit dhe përshkruan karakteristikat e tyre. • Paraqet tiparet e veprave epiko-lirike duke i dalluar elementet epike dhe ato lirike. • Krijon vepra të thjeshta epike për një temë të përcaktuar. Karakteristikat e poezisë epike në vargje përpunohen përmes epikave të përcaktuara në pjesën <i>Historia e letërsisë</i>. <i>Vepra me përmbledhje tregimesh/tregime me zgjedhje për analizë</i> - <i>"Tregime"</i> nga Anton P. Çehovi (tregimet <i>"Njeriu në këllëp"</i> dhe <i>"Një shaka e vogël"</i>) - <i>"Unaza e djerrinës"</i> nga Murat Isaku (tregime me përzgjedhje) - <i>"Anemona"</i> nga Kim Mehmeti (tregime me përzgjedhje) - <i>"Antologji e tregimit shqiptar"</i> nga grup autorësh (tregime me përzgjedhje) - <i>"Novelat e qytetit të veriut"</i> nga Migjeni (novela me përzgjedhje) - <i>"Tregime të zgjedhura"</i> nga Haldun Tanner - <i>"Shenja e ujit"</i> nga Jadranka Vlladova (tregimet <i>"Bitpazari"</i>, <i>"Give me a hug"</i>, <i>Dhurata më e bukur"</i>) - <i>"Gjoni"</i> nga Dragi Mihajlovski (tregimet <i>"Mjeshtri"</i> dhe <i>"Gjoni"</i>) - <i>"Almanaku i dunave të rërës"</i> (tregime me përzgjedhje) nga Dragan Jovanović Danilov <i>Romane me zgjedhje për analizë</i> - <i>"Hekurani në Artas"</i> nga Abdylaziz Islami - <i>"Në rrethana të gabuara"</i> nga Genc Frashëri - <i>"Ditari sekret i Adrian Mole"</i> nga Sju Taunsend

	- <i>"I padukshëm"</i> nga Eloy Moreno - <i>"Zoti i unazave"</i> – pjesa e parë nga John R. R. Tolkien - <i>"Verën që mësova të fluturoj"</i> nga Jasminka Petrovic - <i>"Ti ke një bletë në hundë"</i> nga Venko Andonovski - <i>"Madona me një pallto leshi"</i> nga Sabahattin Ali
Dramatika Historia e dramës dhe e teatrit (teknikat e dramës, paraqitja skenike, akti, skena, prologu, epilogu, dialogu, monologu; tragjedia, komedia, drama; drama bashkëkohore, antidrama)	• Tregon dhe përshkruan karakteristikat themelore të dramës. • Njeh dhe interpreton elemente të strukturës së dramës nëpërmjet analizës specifike të një vepre dramatike. • Krahason veçoritë e llojeve të veprave dramatike të krijuara në periudha të ndryshme. • Shpjegon se si një vepër dramatike shndërrohet për shfaqjen skenike. • Përshkruan rolin e teatrit në zhvillimin e dramës gjatë historisë. • Përgatit dhe realizon monolog ose dialog nga një vepër e dhënë dramatike. <i>Vepra dramatike/fragmente me zgjedhje për analizë</i> - <i>"Koprraci"</i> nga Moliere - <i>"Hamleti"</i> nga Uilliam Shekspiri - <i>"Pas vdekjes"</i> nga A. Z Çajupi - <i>"Nata e trokitjeve në xhama"</i> nga Dhimitër Anagnosti - <i>"Pahintikë në ëndërr"</i> nga Xhabir Ahmeti - <i>"Mishi i egër"</i> nga Goran Stefanovski - <i>"Përfaqësuesi i popullit"</i> nga Branislav Nushiq - <i>"Martesa e poetit"</i> nga Ibrahim Shinasi
Llojet letrare-shkencore (biografia, autobiografia, ditari, eseja)	• Krahason dhe dallon gjinitë letrare-shkencore sipas karakteristikave të tyre. • Vlerëson një vepër të caktuar letrare-shkencore me shkencën dhe publicistikën. • Krijon ese, udhëpërshkrime, biografi.

	Vepra letrare-shkencore për analizë - "Shpikjet e mia" nga Nikola Tesla
Letërsia popullore (poezi, prozë, zhanre të shkurtra folklorike)	• Përcakton karakterin e zhvillimit të letërsisë popullore shqipe dhe kupton rëndësinë kulturore dhe letrare të saj. • Shpjegon procesin e krijimit të artit popullor në kuadër të përcjelljes gojarisht brez pas brezi. • Përcakton karakteristikat e krijimtarisë popullore nëpërmjet zbatimit të veçorive themelore të poezisë lirike dhe epike. • Analizon dhe interpreton lloje të ndryshme të krijimtarisë popullore në poezi dhe në prozë. • Shpjegon rolin e letërsisë popullore në ruajtjen e trashëgimisë kulturore, duke përmendur shembuj të përrallave, këngëve apo fjalëve të urta popullore që pasqyrojnë aspekte të veçanta të traditës. Shembuj për analizë të përzgjedhur nga letërsia popullore shqiptare, maqedonase, turke dhe serbe - Poezia popullore (shembuj të poezive lirike: <i>"Bien tri dajre"</i> - këngë popullore shqiptare; <i>"Të kem dyqan në Strugë"</i> - këngë popullore maqedonase; <i>"Rashë viktimë e syve të tu lajkatarë"</i> – këngë popullore turke; <i>"Oj, vashë, selen-velen"</i> - këngë popullore serbe) - Proza popullore (shembuj të përrallave popullore: <i>"Pesë bukët"</i>, <i>"Vajza e mençur e plakut"</i>, - përralla popullore shqiptare; <i>"Vëllai nuk lëndon vëllanë, mjerë ai që është pa të"</i> – përrallë popullore maqedonase; <i>"Katër këshilla"</i> - përrallë popullore turke; <i>"Çardak as në qiell as në tokë"</i> - përrallë popullore serbe)
HISTORIA E LETËRSISË	
Periodizmi i letërsisë botërore (periudhë letrare, epokë, formacion stilistik)	• Shpjegon se çfarë është periodizimi i letërsisë dhe rendit drejtimet themelore letrare dhe karakteristikat e tyre. • Krahason dhe dallon periudha të ndryshme letrare për nga veçoritë stilistike, tematika dhe ndikimet shoqërore.

Letërsia antike (Bibla, Kurani, letërsia asiro-babilonase, letërsia e lashtë indase, letërsia e lashtë hebreje, letërsia antike greke e romake)	• Përshkruan zhvillimin e letërsisë antike për sa i përket shkrimit, llojeve dhe lidhjes me artet e tjera. • Analizon përmbajtje nga epet <i>“Gilgameshi”</i> dhe <i>“Iliada”</i> dhe dramave të Sofokliut e Aristofanit dhe i krahason ato me mitologjinë. • Numëron specifikat e stilit të Homerit, të Sofokliut, të Aristofanit e të Virgjilit. • Përshkruan personazhet e veprave që analizon dhe i krahason karakteristikat dhe funksionin e tyre. • Përcakton elementet e konfliktit në dramë, personazhin tragjik, momentin tragjik, katarzën (spastrim i shpirtit), teorinë e tre njësive (vendi, koha, ngjarja) të dramës në veprën Antigona. • Përcakton elementet e konfliktit dhe elementet komike të personazheve dhe situatave në komedinë <i>“Bretkosat”</i> e Aristofanit. • Identifikon pikat e përbashkëta të veprës <i>“Eneida”</i> të Virgjilit dhe <i>“Iliada”</i> të Homerit Vepra për analizë - <i>“Gilgameshi”</i> (pllakat I, VI, VIII, XI) - <i>“Iliada”</i> (këngët I, VI, XVIII, XXII, XXIV) nga Homeri - <i>“Antigona”</i> nga Sofokliu - <i>“Bretkosat”</i> nga Aristofani - <i>“Eneida”</i> nga Virgjili
Periodizmi i letërsisë shqipe (shkrimet e para, letërsia e vjetër (mesjeta e vonë), humanizmi shqiptar, letërsia e Rilindjes Kombëtare, letërsia e periudhës mes dy luftrave botërore, letërsia bashkëkohore)	• Shpjegon rrugën zhvillimore të letërsisë shqipe dhe njeh periudhat e saj. • Shpjegon rrethanat historike dhe shoqërore në të cilat janë shkruar dëshmitë e para të gjuhës shqipe. • Identifikon dokumentet e para: <i>“Formula e pagëzimit”</i>, <i>“Fjalorthi”</i> i Arnold von Harfit, <i>“Perikopeja e Ungjëllit”</i> dhe kupton rëndësinë e tyre gjuhësore dhe historike.
Humanizmi dhe renesanca në letërsinë evropiane (humanizmi, renesansa, novela, soneti, romani kalorësiak, parodia, lloji dramatik i komedisë në	• Përshkruan karakteristikat themelore të humanizmit dhe të renesancës si epokë letrare. • Analizon dhe interpreton pjesë të <i>“Ferrit”</i> dhe përcakton karakteristikat themelore të stilit të Dante Aligierit.

renesansë, elemente të tragjedisë: konflikti në dramë, personazhi tragjik, momenti tragjik, efekti tragjik)	• Tregon karakteristikat e poezisë së Petrarkës dhe përshkruan ndikimin e veprës <i>“Kancioneri”</i> në letërsinë evropiane. • Krijon sonet për një temë të caktuar duke përdorur karakteristikat e sonetit. • Shpjegon karakteristikat e novelës së renesansës që e dallojnë atë nga tregimi dhe nga romani. • Përshkruan strukturën e veprës letrare <i>“Dekameroni”</i> të Xhovani Bokaços. • Interpretin tregime të shkurtra sipas kërkesave të dhëna për analizën e një vepre letrare epike (tema, ideja, komploti, personazhet, tregimtari, koha, vendi) • Shpjegon rolin e Shekspirit në zhvillimin e teatrit anglez dhe letërsisë angleze. • Krahason tragjedinë antike me tragjedinë e renesansës përmes analizës së veprës <i>“Romeo dhe Zhuljeta”</i> të Shekspirit duke përcaktuar elementet e tragjedisë. <i>Vepra për analizë</i> - <i>“Komedia hyjnore”</i> nga Dante Aligieri (pjesa e <i>“Ferrit”</i>, kënga hyrëse dhe dy këngë të tjera me përzgjedhje) - <i>“Kancioneri”</i> nga Françesko Petrarka (përzgjedhja e disa soneteve) - <i>“Dekameroni”</i> nga Xhovani Bokaço (përzgjedhja e 3 novelave) - <i>“Don Kishoti”</i> Miguel de Servantes (parathënia dhe përzgjedhje e dy aventurave të Don Kishotit nga pjesa e parë e romanit) - <i>“Romeo dhe Zhuljeta”</i> nga Villiam Shakspir
--	---

Letërsia e vjetër shqipe

(Humanizmi shqiptar, letërsia filobiblike, letërsia arbëreshe, letërsia e bejtexhinjve, letërsia e përkthyer, letërsia origjinale, karakteri fetar, alfabetet, transkriptimi, transliterimi)

- Përshkruan karakteristikat themelore të humanizmit shqiptar dhe kushtet shoqërore-ekonomike të kohës, në të cilën u paraqit ai.
- Dallon karakterin fetar të letërsisë së vjetër shqipe.
- Identifikon karakterin përkthyes dhe original të veprave letrare.
- Analizon kryeveprën e Marin Barletit *“Historia e Skënderbeut”* dhe identifikon elementet historike dhe ato letrare.
- Identifikon *“Mesharin”* e Gjon Buzukut dhe shpjegon rëndësinë e kësaj vepre në letërsinë, gjuhën dhe kulturën shqiptare në përgjithësi.
- Shpjegon rolin që luan Lekë Matrënga dhe vepra *“E mbsueme e krishterë”* në historinë e letërsisë shqipe, si përfaqësues i parë i letërsisë arbëreshe.
- Shpjegon karakterin dhe strukturën e veprës *“Pasqyra e t’rrëfyemit”* dhe kontributin e Pjetër Budid si përkthyes tekstesh letrare dhe autor i poezisë dhe prozës origjinale.
- Shpjegon rëndësinë leksikore, gjuhësore dhe folkloristike të veprës *“Fjalor latinisht-shqip”* dhe kontributin e Frang Bardhit në mesin e autorëve të letërsisë së vjetër, si autor i veprës së parë pa elemente fetare.
- Identifikon tiparet artistike të veprës *“Çeta e profetëve”* të Pjetër Bogdanit dhe elementet e saj filozofike, teologjike dhe shkencore.
- Përshkruan strukturën dhe veçantitë e përmbledhjes së vjershave e poemave fetare në veprën *“Gjella e Shën-Mërisë virgjër”* të Jul Variboba.
- Identifikon letërsinë shqipe me alfabet arab dhe shpjegon rrethanat në të cilat u krijua letërsia e bejtexhinjve.
- Analizon poezitë e Nezim Frakullës dhe shpjegon ndikimet orienale dhe gjuhën e përdorur në to.
- Analizon poezitë e Hasan Zyko Kamberit dhe shpjegon preokupimet kryesore tematike.
- Njih elementet kuranore, gjegjësisht biblike në paratekstin e veprës *“Jusufi dhe Zylihaja”* të Muhamet Kyçkut.
- Analizon dhe interpreton pjesë nga poema *“Erveheja”* dhe përcakton veçoritë themelore të stilit të Muhamed Kyçkut.

	Vepra për analizë - <i>"Historia e Skënderbeut"</i> nga Marin Barleti - <i>"Meshari"</i> nga Gjon Buzuku - <i>"E mbsueme e krishterë"</i> nga Lekë Matrënga - <i>"Pasqyra e t'rrëfyemit"</i> nga Pjetër Budi - <i>"Fjalori latinisht-shqip"</i> nga Frang Bardhi - <i>"Çeta e profetëve"</i> nga Pjetër Bogdani - <i>"Gjella e Shën-Mërisë virgjër"</i> nga Jul Variboba - <i>"Divani"</i> nga Nazim Frakulla - Poezitë <i>"Paraja"</i> dhe <i>"Trahanaja"</i> nga Hasan Zyko Kamberi - <i>"Erveheja"</i> dhe <i>"Jusufi dhe Zylihaja"</i> nga Muhamet Kçykyku
TË SHPREHURIT DHE KRIJIMTARIA	
Prezantim me gojë /fjalim (biseda, tema, argumentimi, qëndrimi, mendimi, elemente në tekst, fjalim drejtuar publikut) Ese (zgjedhja e temës, plani i të shkruarit, hyrja, pjesa kryesore, argumentet dhe përfundimi, literatura e shfrytëzuar dhe burimet) Të shkruarit krijues (forma të strukturuar poetike: soneti, gazeli, balada, haiku)	• Njih dallimet në të shprehurit me gojë në mënyrë formale dhe joformale sipas fjalorit të përdorur. • Përgatit fjalim me temë të caktuar ose të zgjedhur, për t'iu drejtuar publikut në mënyrë formale dhe joformale. • Shpreh qëndrimin e vet dhe jep mendim për një tekst, libër apo një artikull të lexuar, për një film, ngjarje apo festival të ndjekur etj., duke përdorur argumentimin e duhur. • Formulon një tezë të qartë për pjesën hyrëse të një eseje dhe jep argumente, shembuj dhe shpjegime përkatëse për të mbështetur tezën në pjesën kryesore. • Shkruan një paragraf, duke zbatuar strukturën e tij standarde: fjalinë kryesore, shtjellimin, shembuj ose dëshmi dhe mendimin përmbyllës. • Lidh idetë në ese në mënyrë logjike dhe të kuptueshme, duke përdorur kalimin e duhur ndërmjet paragrafëve. • Shkruan ese për një temë të caktuar apo të zgjedhur me një strukturë qartë të përcaktuar. • Shkruan tekste në prozë me hyrje, me pjesë kryesore dhe me përfundim.

- Krijon forma të strukturuar poetike (sonet, gazel, baladë, haiku).

Shembuj veprimtarish:

Veprimtari individuale

- Nxënësit hulumtojnë mitet nëpërmjet internetit, informacione për origjinën e miteve dhe rëndësinë e tyre në letërsi (dhe artet e tjera) si bazë për krijimin e veprave të rëndësishme letrare nga lashtësia e deri më sot. Ata tregojnë shembuj dhe lidhin mitin me veprat që janë pjesë e programit për lexim të detyrueshëm, si dhe mund ta lidhin praninë e miteve edhe me filma që kanë parë (dhe vepra të tjera arti që kanë parë), duke folur për ndikimin e mitologjisë në artin në përgjithësi. Në fund të diskutimit, ata shkruajnë shembujt konkretë dhe në bazë të tyre shkruajnë një ese për detyrë shtëpie, duke zgjedhur nga një shembull secili.

Veprimtari praktike

- Nxënësit analizojnë një histori duke kërkuar veçori narrative karakteristike për të. Gjatë analizës, ata shkruajnë veçoritë dhe i përdorin ato më tej në interpretim.
- Nxënësit zgjedhin citate rreth disa aspekteve të prozës, për shembull, shprehjet dhe sjelljet e një personazhi. Gjatë interpretimit të citateve, interpretohet edhe sjellja e personazhit brenda tekstit dhe shpjegojnë se si ajo ndikon në ngjarje të tjera.
- Nxënësit lexojnë një tekst në prozë, identifikojnë temën dhe motivet kryesore dhe japin mendimin e tyre për mënyrën e paraqitjes së problemit në tekst.

Diskutim

- Nxënësit diskutojnë për çështjet kyçe të humanizmit dhe renesansës, cilat tema dhe motive janë të pranishme në shembujt që lexojnë: nëse motivet janë personale apo shoqërore, në cilat vepra dhe në çfarë mënyre pasqyrohet ato, nëse ka forma të caktuara të shprehjeve në këtë periudhë letrare, pse janë kaq specifike dhe ku shihen ato në shembujt që lexojnë. Nga diskutimi nxirren përfundime.

Kuize dhe gara

Nxënësit marrin pjesë në garën të titulluar *"Kush është njohësi më i mirë i poezisë?"*, ku u përgjigjen pyetjeve objektive që lidhen me gjuhën poetike, figurat stilistike dhe interpretimin e një vepre të caktuar poetike.

Fusha programore: **NJOHURI MEDIATIKE**

Gjithsej: 14 orë

Rezultatet e të nxënit:

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:

1. të analizojë përmbajtjen e medias për të ndarë faktet nga opinionet dhe për të njohur paragjykimet dhe manipulimet;
2. të përdorë mjetet që ka në dispozicion për të kontrolluar faktet dhe për të përcaktuar besueshmërinë e informacionit;
3. të identifikojë teknikat që krijojnë lajme të rreme dhe të shpjegojë se si ato ndikojnë në perceptimin e audiencës;
4. të analizojë debatet online për të përcaktuar ndikimin e dezinformimit, manipulimit dhe gjuhës së urrejtjes.

Nxënësi/nxënësja:

1. do të zhvillojë strategji të të menduarit kritik që ndihmojnë në ruajtjen e objektivitetit gjatë leximit të përmbajtjes mediatike;
2. do të zhvillojë vetëdijen se si paragjykimet e dikujt tjetër mund të rrisin rrezikun për të besuar lajmet e rreme;
3. do të vlerësojë lirinë e shprehjes, por edhe do të pranojë se gjuha e urrejtjes nuk mund të justifikohet me këtë të drejtë.

Përmbajtjet (dhe nocionet/konceptet)	Standardet e vlerësimit:
Fakte dhe opinione	• Shpjegon dallimin ndërmjet fakteve dhe opinioneve që përdoren në media. • Ndan faktet nga opinionet në tekste apo në raportime mediatike. • Analizon tekste gazetareske për të vërtetuar se si autori kombinon faktet dhe opinionet për të krijuar paragjykime.
Burime të informacionit (media zyrtare, blogje, media sociale; besueshmëri, vërtetësi)	• Tregon karakteristikat e burimeve të ndryshme të informacionit (media zyrtare, blogje dhe media sociale) dhe shpjegon se si ato ndryshojnë nga njëra-tjetra. • Zbaton kriteret për kontrollimin e besueshmërisë së burimeve të informacionit në disa shembuj që merren nga lloje të ndryshme burimesh. • Analizon shembuj nga media dhe burime të tjera për të përcaktuar nëse ato janë të vërteta dhe të besueshme.

Vërtetim i fakteve (verifikim, vegla për verifikimin e vërtetësisë së fakteve)	• Demonstron procesin e verifikimit të informacionit duke përdorur burimet online dhe veglat për verifikimin e vërtetësisë së fakteve. • Përcakton besueshmërinë e informacionit të dhënë duke aplikuar veglat adekuate.
Paragjykimi dhe manipulimi	• Shpjegon se si paragjykimet dhe manipulimet futen në përmbajtjen mediatike. • Shpjegon se si manipulimi i përmbajtjes mediatike ndikon në ndërgjegjësimin dhe në mendimin kritik të audiencës. • Krahason përmbajtjen e njëanshme dhe të paanshme për të përcaktuar dallimet në objektivitet dhe saktësi. • Analizon një përmbajtje të dhënë mediatike (përfshirë titujt e mediave) për të përcaktuar nëse dhe në çfarë mase ato janë të njëanshme apo manipuluese.
Dezinformatata dhe lajme të rreme	• Shpjegon se si shpërndahen informacionet e rreme nëpër media. • Shpjegon se si informacioni i rremë ndikon në opinionin publik dhe në vendimmarrje. • Vlerëson rëndësinë dhe saktësinë e informacionit duke përdorur burime të verifikuara dhe vegla të ndryshme për verifikim. • Identifikon teknikat e përdorura për të krijuar lajme të rreme, të tilla si raportimi selektiv, përdorimi i gjysmë të vërtetave ose nxjerrja e informacionit jashtë kontekstit.
Manipulimi me imazhe dhe me video	• Shpjegon se si imazhet dhe videot ndryshohen për të krijuar dezinformata ose për të përhapur propagandë në mënyrë që të formësojë perceptimin e realitetit dhe të ndikojë në opinionin publik. • Demonstron se si të zbatohen teknikat bazë për manipulim digjital me imazhe dhe me video, të tilla si fotoshopi, ndryshimi i kontekstit dhe paraqitja selektive. • Aplikon vegla të ndryshme për të vërtetuar nëse imazhet ose videot janë ndryshuar dhe identifikon elementet vizuale që tregojnë manipulim.
Debatet online dhe gjuha e urrejtjes	• Lidh konceptet e dezinformimit dhe manipulimit me ndikimin e tyre në cilësinë e debateve online.

- Njeh format e ndryshme të gjuhës së urrejtjes (nga fyerjet e drejtpërdrejta deri te mënyrat delikate të diskriminimit apo nxitjes së dhunës) në përmbajtjet tekstuale, në audio dhe vizuale në rrjetet sociale.
- Shpjegon pasojat e dëmshme të gjuhës së urrejtjes tek individët dhe te grupet shoqërore.
- Shpjegon lidhjen mes gjuhës së urrejtjes dhe lirisë së shprehjes.
- Bën dallimin mes kritikës konstruktive dhe gjuhës së urrejtjes në kontekste të ndryshme.

Shembuj veprimtarish:

Analizë e artikujve

- Nxënësve u jepen dy tekste për të njëjtën ngjarje nga media të ndryshme. Ata analizojnë individualisht, identifikojnë faktet, opinionet dhe paragjykimet dhe më pas i paraqesin para klasës gjetjet e tyre.

Veprimtari praktike

- Të ndarë në grupe, nxënësve u jepet një sërë përmbajtjesh mediatike. Ata përdorin vegla për verifikimin e fakteve në internet (p.sh. Google Fact Check Explorer). Më pas ata prezantojnë rezultatet dhe tregojnë sfidat me të cilat u përballën gjatë procesit të verifikimit.
- Nxënësit, të ndarë në grupe, krijojnë një prezantim që demonstroi se si ndryshohet përmbajtja vizuale për të ndikuar në perceptimin e publikut.

Simulim dhe luajtja në role

- Nxënësit ndahen në grupe ku secili grup është një "bord redaktues". Anëtarëve të grupit u jepen role të ndryshme (kryeredaktor, verifikues faktesh, analist i manipulimeve dhe studiues i burimeve) dhe në përputhje me rrethanat analizojnë një sërë "lajmesh mediatike" që përmbajnë një kombinim faktesh dhe opinionesh, përmbajtje të njëanshme e të paanshme dhe disa shembuj të manipulimit (lajme gjysmë të vërteta, paraqitje selektive dhe/ose informacione të nxjerra nga konteksti). Pas analizimit të lajmeve, grupet vendosin se cilat lajme do të publikojnë dhe shpjegojnë pse.

Diskutim

- Mësimdhënësi/ja fillon një diskutim të hapur me të gjithë nxënësit me temën: *“Pse duhet të ndalohet dhe të sanksionohet gjuha e urrejtjes?”* Gjatë diskutimit, nxënësit perceptojnë pasojat e dëmshme të gjuhës së urrejtjes tek individët dhe te grupet të cilave u referohet (diskriminim, izolim dhe dhunë ndaj grupeve të caktuara etnike, fetare ose grupeve të tjera të marginalizuara).

Veprimtari krijuese

- Nxënësit, të ndarë në grupe, krijojnë një burim edukativ (video, artikull ose infografik) në të cilin shpjegojnë se si shpërndahen informacione të rreme nëpër media.

GJITHËPËRFSHIRJA, BARAZIA / NDJESHMËRIA GJINORE DHE INTEGRIMI NDËRKULTUROR

Mësimdhënësit/et në arsimin e gjimnazit nxisin gjithëpërfshirjen duke siguruar përfshirje aktive të të gjithë nxënësve në aktivitetet mësimore. Ata përshtasin në mënyrë adekuate metodat e punës për t'iu përgjigjur nevojave të ndryshme njohëse dhe emocionale të nxënësve, duke përdorur qasje të tilla si individualizimi, diferencimi, punë në grupe dhe mbështetje nga shokët/shoqet e klasës. Gjatë punës me nxënësit me aftësi të kufizuara, mësimdhënësit zbatojnë plane arsimore individuale që përfshijnë rezultate të të nxënësve dhe standard vlerësimi të personalizuar dhe ofrojnë mbështetje shtesë nga asistentët arsimorë, ndërmjetësit, tutorët vullnetarë dhe profesionistët nga qendra të ndryshme burimore.

Ndjekja e rregullt e përparimit të nxënësve, veçanërisht të grupeve të ndjeshme (vulnerabël) është thelbësore. Mësimdhënësit/et identifikojnë vështirësitë e mundshme në kohën e duhur dhe ofrojnë udhëzime për tejkalimin e tyre, duke dhënë mbështetje të duhur për arritjen e rezultateve të të nxënësve. Kjo qasje jo vetëm që inkurajon arritjet akademike, por gjithashtu ndërton vetëbesimin e nxënësve dhe ndjenjën e tyre të përkatësisë.

Për barazinë gjinore, mësimdhënësit/et duhet të jenë të kujdesshëm që të mos promovojnë dhe inkurajojnë role stereotipike gjinore gjatë organizimit të aktiviteteve. Gjatë formimit të grupeve të punës ose caktimit të detyrave, mësimdhënësit/et sigurojnë ekuilibër midis djemve dhe vajzave, ndërsa duke përdorur shembuj, tekste dhe ilustrime, ata mbështesin ndjeshmërinë gjinore dhe inkurajojnë nxënësit të kapërcejnë stereotipet gjinore. Procesi mësimor planifikohet në mënyrë që barazia gjinore dhe ndjeshmëria etnike/kulturore të jenë pjesë e natyrshme e të gjitha aktiviteteve, veçanërisht përmes përdorimit, kudo që është e mundur, të materialeve dhe përmbajtjeve që promovojnë ndërkulturalizmin dhe integrimin ndëretnik.

Mësimdhënësit/et i njohin nxënësit me perspektiva të ndryshme kulturore përmes aktiviteteve që nxisin respektimin e diversitetit në të gjitha situatat e mundshme. Kjo u mundëson nxënësve të zhvillojnë ndërgjegjësim për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin ndërkulturor, që është baza për krijimin dhe zhvillimin e një shoqërie kohezive dhe në harmoni.

VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE

Për t'ua mundësuar nxënësve t'i arrijnë standardet e pritura të vlerësimit, mësimehmënësi/ja ndjek vazhdimisht aktivitetet e nxënësve gjatë mësimehmënies dhe gjatë të nxënësve duke mbledhur informacione në lidhje me përpunimin e secilit nxënës. Për pjesëmarrjen në aktivitete, nxënësve marrin informacione kthyes të cilat tregojnë nivelin e suksesit gjatë realizimit të aktivitetit/detyrës dhe japin udhëzime për përmirësim (vlerësim formativ). Për këtë qëllim, mësimehmënësi i përcjell nxënësve dhe vlerëson:

- përgjigjet me gojë për pyetjet e bëra nga mësimehmënësi ose nga nxënësve të tjerë;
- veprimtaritë hulumtuese përmes të cilave nxënësve heton: për karakteristikat e gjuhës, për përdorimin e gjuhës standarde të folur dhe të shkruar në lloje të ndryshme komunikimi, për përdorimin e drejtshkrimit në të shprehurit me shkrim në lloje të ndryshme tekstesh e kontekstesh dhe periudha e epoka të caktuara, duke lidhur prirjet shoqërore dhe prirjet e tjera zhvillimore me veprën/autorin;
- prezantimet për tema të ndryshme që lidhen me të tri fushat programore;
- prezantimet për analizë dhe interpretim të teksteve letrare dhe jolettrare përmes citimeve, argumenteve dhe shembujve;
- punimet e ndryshme me fjalime, me ese, me forma letrare poetike dhe me prozë;
- raportet e shkruara që paraqesin të dhëna dhe informacione në formate e në forma të ndryshme duke përdorur paraqitje objektive nga burimet përkatëse;
- detyrat e shtëpisë;
- përgjigjet e kuizeve (teste të shkurtra) që janë pjesë e mësimehmënies;
- pjesëmarrjen dhe angazhimin në aktivitete, diskutime dhe punë ekipore.

Nxënësve merr notë sumative (përmbledhëse) për standardet e arritura të vlerësimit. Vlerësimi sumativ kryhet duke kombinuar rezultatin e arritur nga testet e njohurive me vlerësimin e progresit të konstatuar nëpërmjet teknikave të ndryshme të vlerësimit formativ. Gjatë vitit shkollor dhe në fund të vitit nxënësve merr notën sumative (përmbledhëse) me numër.

Почеток на имплементација на наставната програма Fillimi i zbatimit të programit mësimor	учебна 2025/2026 година Viti shkollor 2025/2026
Институција/носител на програмата Institucioni/bartësi i programit mësimor	Биро за развој на образованието Byroja e Zhvillimit të Arsimit

Согласно член 22 став 1 од Законот за средното образование („Службен весник на Република Македонија“ бр. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16 и 67/17, 64/2018 и „Службен весник на Република Северна Македонија“ бр. 229/2020), министерката за образование и наука ја донесе наставната програма по предметот *Албански јазик и литература* за I (прва) година гимназиско образование.

Sipas nenit 22 paragrafi 1 i ligjit për arsimin e mesëm ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/03, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16 dhe 67/17, 64/2018 dhe "), Ministrja e Arsimit dhe Shkencës miratoi programin mësimor të lëndës *Gjuhë shqipe dhe letërsi për vitin I* (e parë) të arsimit të gjimnazit.

бр. 13-5306/12 од
03.04.2025 година

Министерка за образование и наука,
проф. д-р Весна Јаневска, с.р.